



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republik of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale nr.03/L-040 dhe nenin 16 të Statutit të Komunës së Podujevës nr.01-020/01-0050862/18, Kryetari i Komunës, nxjerr:

URDHËRESË

I.

1.Kërkohet nga Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale-DSHMS dhe Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare-QKMF Podujevë, që në mënyrë permanente të përcjellin procesin e furnizimit të barërave dhe materialeve tjera mjekësore dhe të përkujdesen në administrimin strikt të tyre përmes një sistemi monitorues sa i përket regjistrimit, shpërndarjes dhe çështjeve tjera përkatëse, varësisht nevojave dhe kërkesave, në përputhje me rregullativën ligjore.

2.Çdo pranim dhe dorëzim apo shpërndarje e barërave dhe materialeve tjera mjekësore të evidentohen në regjistrat përkatës/data bazë.

II.

Për çdo lëshim eventual nga ana e zyrtarëve/personelit përgjegjës do të merren masa disiplinore dhe masa tjera ligjore.

III.

Për zbatimin e Urdhëresës kujdesen Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare-QKMF Podujevë.

IV.

Për punët dhe detyrat sipas kësaj Urdhërese kërkohen raporte sistematike të detajuara. Raportet paraqiten në Zyrën e Kryetarit të Komunës përmes Drejtores së Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.

V.

Urdhëresa hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

U dërgohet:
Drejtores së DSHMS-së
U.D. Drejtorit të QKMF-së
Zyrtarëve/personelit përkatës vartës
Arkivit

Nr.02-500/04-0076976/20
Podujevë, 21 dhjetor 2020

Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi

